



Erasmus+

UDHËZUES PËR TRAJNUESIT E ARSIMIT JOFORMAL PËR PUNËSIMIN E TË RINJËVE ROMË

Erasmus+



Co-funded by the
Erasmus+ programme
of the European Union



SEANCA 1	4
1.1 Punëtorja kompjuteristike e Sabinës.....	4
1.2 Njoftim me aplikacionet Viber и What’s Up	5
SEANCA 2	7
2.1 Aftësitë për vetëvlersim	7
2.2 Ese personale rreth aftësive për punësim	8
SEANCA 3	9
3.1 Studim i shpalljeve për punë	9
3.2 Studim i shpalljeve online për punë	10
SEANCA 4	11
4.1 Zgjedhja e karrierës së Aleksandrit.....	11
4.2 Njoftimi me Skype.....	12
4.3 Bisedë pune në Skype	12
SEANCA 5	14
5.1 Dilema për krijimin e CV.....	14
5.2 Kërkimi online i formateve për CV	16
5.3 Krijimi i CV-së personale	16
SEANCA 6	17
6.1 Punësimi tek romët	17
6.2 Loja „Besilka“ me fjalët kyçe prej ushtrimit 6.1	19
6.3 Të shkruhet një ese e shkurtër mbi situatën e punësimin të romëve	19
SEANCA 7	20
7.1 Kategorizimi i aftësive për punësim.....	20
7.2 Matrica e aftësive për punësim	21
SEANCA 8	27
8.1 Intervistë pune: Çfarë të bësh, dhe çfarë jo.....	27
8.2 intervistë për punë: loja në rrole	28
SEANCA 9	30
9.1 Sfidat për punësimin e të rinjëve Romë	30
9.2 Loja „Besilka“	31
9.3 Të shkruhet ese e shkurtër për sfidat e punësimin tek Romët	31
SEANCA 10	32
10.1 Mësoni të mos pajtoheni: loja në rrole.....	32
10.2 Rëndësia e mediave sociale në kërkim të punës:.....	33

SEANCA 11	34
11.1 Komunikimi profesional me E-mail.....	34
SEANCA 12	36
12.1 Analiza SWOT e punësimit personal.....	36
12.2 Komunikim: ballafaqimi me klient të komplikuar	37
SEANCA 13	38
13.1 Prezentim publik me Power Point	38
SEANCA 14	39
14.1 Shkuarja në intervistë pa përgjigje të kthyer	39
14.2 Puna me CV: Vazhdim	40
SEANCA 15	41
15.1 Organizimi i ngjarjes.....	41
SEANCA 16	43
16.1 Komunikim/ kërkim pune: Thirje telefonike për kërkim pune	43
16.2 Komunikim: Prezentim publik duke shfrytëzuar Power Point.....	43
SEANCA 17	44
17.1 Biznes Plan i shkurter 1	44
17.2 Puna me aplikacionet mobilje – matematikë bazike	45
SESSION 18.....	46
18.1 Shkrimi efektiv i letrave motivuese.....	46
18.2 Aftësi për punësim të rëndësishme për pozicione të ndryshme të punës	46
SEANCA 19	48
19.1 Organizimi i ngjarjes	48
SESSION 20.....	50
20.1 Planifikimi i shpejtë i biznesit 2 (Vazhdim): Të ardhurat dhe shpenzimet.....	50
SEANCA 21	53
21.1 Menaxhimi i konfliktit në një situatë pune.....	53
SEANCA 22	58
22.1 Planifikimi i shkurtër i biznesit 3- Përshkrimi i tregut dhe strategjia e shitjeve	58
22.2 Puna me aplikacionet mobilje – matematikë bazike.....	58
SEANCA 23	59
23.1 Sjellja e vendimit	59
SEANCA 24	62
24.1 Planifikimi i shkurtër i biznesit 4 (vazhdimi) - konkurrenca.....	62
24.2 SWOT analiza e punësimit personal	64

SEANCA 1

1.1 Punëtorja kompjuteristike e Sabinës

Ju lutem të lexoni tekstin në vijim:

Sabina jeton në një lagje të madhe rreth në Shuto Orizarë të Shkupit. Ajo filloi të punojë me kompjuter prej në fëmijëri. Ajo vazhdoi ta përdor rregullisht gjatë kohës kur ishte në shkollë fillore dhe të mesme. Sabina u bë e aftë për instalimin e programeve të ndryshme, përdorimin e atyre programeve dhe zgjidhje të problemeve të ndryshme kur kishte nevojë. Puna me kompjuter i ndihmoi që ta mëson edhe anglishten. Në lagje u përhap se Sabina është shumë e mirë në kompjuter. Njerzit thonin se ajo ishte e lindur për kompjuter. Fëmijët e tjerë nga lagja, si dhe prindërit e tyre filluan t'i kërkonin asaj për ti riparuar kompjuterët e tyre kur ju ndodhte diçka. Në fillim ajo kishte pasur disa telefonata në muaj, por me kalimin e kohës, duke u zgjeruar, filloi të ketë nga 15 telefonata në muaj. Në fillim njerëzit i jepnin bakshishe të vogla. Megjithatë, duke ju rritur puna, ajo caktoi çmim për shërbimet që i ofronte. Me kalimin e kohës, i vinte më lehtë kur njerzit i'a sillnin kompjuterët në shtëpi. Ajo bëri një puntori në një nga dhomat e shtëpisë së saj dhe kalonte më shumë kohë në riparimin e kompjuterëve. Në fillim ajo bënte riparim të softverit. Nuk mundej të zgjidhte problemet me hardwerin. Megjithatë, kuptoi se njerëzit kanë shumë problem edhe me hardwerin, dhe vendosi që ta mesojë edhe atë. Në dy vitet e fundit të shkollës së mesme, ndoqi një kurs për riparim të hardwerit. Gjithashtu mori licencë që verteton se ajo mund të meret me zgjidhjen e problemeve të këtij lloji. Në moshën 18 vjeçare kishte puntorinë e vetë për kompjuter e cila ishte e njohur në tërë lagjen. Ajo e regjistroi biznesin e saj dhe angazhoi një asistent të punojë me gjysëm orari. Ai ishte Ashmeti, një djalë i rri nga lagja, i cili gjithashtu kishte aftësi për kompjuter. Ashmeti punonte në mëngjes, përderisa Sabine ndiqte ligjeratat në univerzitet. Ajo u regjistrua në shkenca kompjuterike, duke vendosur që të specializohet edhe më tej në këtë fushë. Në shumë aspekte ajo ishte një hap më para nga kolegët e saj, sepse kishte përvojë të madhe praktike.

Termet kryesore:

Aftësi	Aftësia për të bërë diçka mirë.
Shërbim	Të punosh diçka për dikë. Aktivitet ekonomik në të cilin nuk është prodhuar diçka materiale në fund të procesit të punës.
Puntori	Vend ku prodhohen ose riparohen gjërat.
Softveri kompjuterik	Programet e përdorura në kompjuter.
Hardweri	Pjesët fizike të kompjuterit.
Licenca	Leje për të punuar diçka. Teksti i referohet një leje ligjore, për të udhëhequr aktivitet ekonomik, udhëhequr biznes.
Specializim	Të koncentrohesh në një drejtim, dhe të bëhesh shumë i mire në të.
Përvoja praktike	Përvojë pune, përvojë për të bërë diçka.

1.2 Njoftim me aplikacionet Viber и What's Up

Qëllimi i ushtrimit është të njoftohen pjesmarrësit me përdorimin e Viber dhe What's Up, veçanërisht në përdorimin për qëllime pune.

Tema që duhet të përfshihen:

Hapja e llogarisë Viber dhe What's Up

Përdorim i përgjegjshëm i Viber dhe What's Up

Puna me kontaktet

Shfrytëzimi i Viber dhe What's Up për biznes komunikim

Roli 1:

Ahmeti punon në agjension turistik dhe është përgjegjës për marjen me qira të apartamenteve private për turistet që vijnë në qytet (qyteti është vendi ku jetojnë pjesmarrësit; ato duhet ta njohin mirë vendin).

Suzan arrinë në qytet sonte. Ajo pyet për adresën e saktë, lagjen ku ndodhet apartamenti, sigurinë, lëvizjen rreth qytetit, vende për të ngrënë, pagesat, etj. Ajo kur të arrijë do të ketë qasje të kufizuar në internet për këtë arsye, dëshiron që të mer sa më shumë informacione që është e mundur. Do të qëndroj në qytet 4 ditë. Ahmeti mundohet që ti sigurojë sa më shumë informacione.

Rroli 2:

Sabina punon për një operator kabllorik. Ajo është përgjegjëse për kujdesin ndaj klientëve. Ajo pranon ankesat përmes telefonit, por edhe përmes porosive. Mund të ju ndihmon shfrytëzuesve me probleme më të thjeshta teknike dhe i drejton deri tek përkrahja teknike për rastet më të komplikuar. Sabina ka shumë reagime nga konsumatorët e zemëruar, sepse ato shpesh here kanë problem me internetin apo me televizionin kabllorik. Rexhepi është njëri prej atyre konsumatorëve. Ka pasur problem me internetin gjatë tërë ditës, ndërsa ka afat të caktuar për kryerjen e disa punëve dhe është i nervozuar. Ai është i moshuar dhe ka pak njohuri nga kompjuteri. Sabina ia tregon disa hapa të lehtë që ta ndihmojë të rregullojë internetin.

Rroli 3:

Xhenifer punon në një kompani për tregëti online dhe puna e sajë është të komunikon me klientët të cilët blejnë prodhime të caktuara. Kompania punon me klientë nga jashtë dhe pjesa më e madhe e komunikimit është me mesazhe tekstuale , më shpesh përmes Viber ose What's Up. Puna e sajë është të ju spjegoj klientëve për benefitet e prodhimit dhe të ndihmoj në shitje. Risto është klient i shtetit fqinjë dhe është i interesuar për të blerë telefon të rri. Ai ka më shumë pyetje rreth funksioneve të telefonave celular.

SEANCA 2

2.1 Aftësitë për vetëvlersim

Ju lutem, bëjeni vetëvlersimin në vijim:

1 = plotësisht nuk pajtohem; 5 = plotësisht pajtohem

Lexim

1	Di të lexoj	1 2 3 4 5
2	Di të lexoj mirë	1 2 3 4 5
3	Lexoj rregullisht	1 2 3 4 5
4	Lexoj diçka rregullisht	1 2 3 4 5
5	Di të lexoj dhe i kuptoj të gjitha fjalët që i shkruajnë miqt e mi në rrjete sociale	1 2 3 4 5
6	E lexoj leht përmbajtjen e web portaleve për të rinj	1 2 3 4 5
7	Mundem lehtë ti lexojë lajmet ditore	1 2 3 4 5

Shkrim

1	Di ti shkruaj të gjitha shkronjat	1 2 3 4 5
2	Mund ti shkruaj fjalët dhe fjalitë sakt	1 2 3 4 5
3	Gjithmon ju kushtoj vëmendje shenjave të piksimit siç janë shkronjat e mëdha, pikat, presjet, pikëpyetjet, etj.	1 2 3 4 5
4	Di si të shkruaj e-mail	1 2 3 4 5
5	Shkruaj mejll rregullisht	1 2 3 4 5
6	Di të shkruaj e-mail me shpejtësi mesatare	1 2 3 4 5
7	E shkruaj atë që dua ta them qartë dhe preciz	1 2 3 4 5
8	Aftësitë e mija për të shkruar janë më të mira nga shokët e klasës	1 2 3 4 5

Punë me numra

1	Di si të mbledh numra	1 2 3 4 5
2	Mbledhja e numrave është e lehtë për mua	1 2 3 4 5
3	Di si të zbres numra	1 2 3 4 5
4	Zbritja e numrave është e lehtë për mua	1 2 3 4 5
5	Di si të shumëzoh numra	1 2 3 4 5
6	Shumëzimi i numrave është i lehtë për mua	1 2 3 4 5
7	Di si ti pjestoj numrat	1 2 3 4 5
8	Pjestimi i numrave është i lehtë për mua	1 2 3 4 5
9	Unë isha më i miri në Matematikë nga të gjith shokët e klasës	1 2 3 4 5
10	Unë isha më i keqi në Matematikë nga të gjithë shokët e klasës	1 2 3 4 5

Aftësitë kompjuterike

1	Di të punoj në kompjuter	1 2 3 4 5
2	Punoj në kompjuter rregullisht	1 2 3 4 5
3	Kam njohuri të mira për Word	1 2 3 4 5
4	Kam njohuri të mira për Excel	1 2 3 4 5
5	Di si të vendos formula të thjeshta në Excel	1 2 3 4 5
6	Di si të bëj tabelë në Excel	1 2 3 4 5
7	Kam njohuri të mira për Power Point	1 2 3 4 5

Komunikimi verbal

1	Flas qartë	1 2 3 4 5
2	Jam i/e kujdesshëm/e për fjalët që i flas. Nuk tregoj diçka që nuk dua ta them	1 2 3 4 5
3	Di si ti kontrolloj emocionet e mia (zemërimin, mosdurimin me njerëz, zhgënjimin, etj) kur flas	1 2 3 4 5
4	Lë përshtypje të mirë kur diskutoj në grup (familjar, shokë)	1 2 3 4 5
5	Mund ti bindë njerëzit	1 2 3 4 5
6	Njerëzit më konsiderojnë si dëgjues të mirë	1 2 3 4 5

2.2 Ese personale rreth aftësive për punësim

Shkruani ese personale për aftësitë e juaja. Tregoni aftësitë që i posedoni dhe punët që mendoni se mund ti kryeni me sukses. Gjithashtu shkruani edhe aftësitë që ju mungojnë, si dhe aftësitë që doni ti zhvilloni. Mund të shkruani për çfarë keni pasur më shumë interes si fëmijë, hobi, gjërat në të cilat keni qenë më të mirë. Mund të shkruani për gjërat që i doni ose që ju interesojnë. Esee duhet të përmban rreth 500 fjalë.

SEANCA 3

3.1 Studim i shpalljeve për punë

Hidhni një sy konkurseve tjera për punësim. Çfarë kanë të përbashkët të gjitha konkurset? Cilat janë aftësitë që kërkohen më shpesh? Si mund të fitohen këto aftësi?

Shpallje për punë 1

Pozicioni që kërkohet

Projekti i rri i financuar nga BE kërkon menaxher të zyrës.

Përgjegjësitë

- Menaxhim i përditshëm i zyrës;
- Ta ndihmon udhëheqësin e grupit;
- Menaxhim Financiar;
- Organizimin e ngjarjeve.

Aftësitë dhe kualifikimet

- Të shkruaj dhe të flasë gjuhën Angleze mirë;
- Diplomë Univerzitare;
- Minimum përvojë 1 vjeçare në zyrë;
- Përvojë në raportet financiare;
- Aftësi organizative për Menaxhment.

Shpallje për punë 2

Pozicioni që kërkohet

Ky pozicion nënkupton përgjegjësi për aktivitetet e zyrës. Personi i angazhuar në këtë pozicion duhet të sigurojë udhëheqjen dhe menaxhimin me grupën për aktivitetet e

zyrës. Sferat e menaxhimit të zyrës përfshijnë: administrimin e zyrës, postën, arkivën, taksat, planifikimin e konferencave dhe takimeve si dhe mbështetjen administrative...

Përgjegjësitë:

E udhëheqë dhe e menaxhon grupin operativ;

Vazhdimisht e vlerëson punën e stafit dhe aftësitë e nevojshme, si dhe shërbimet e ofruara për klientët;

Mer pjesë në detyrat e përditshme dhe i ndanë përgjegjësitë me antarët e tjerë të grupit administrativ;

Menaxhimi i buxhetit vjetor, përgaditja e rrogave;

Përgjegjës për harxhimet materiale;

Zgjedhës i konflikteve.

Kualifikimet:

Pesë ose më shumë vjet përvojë pune si menaxher i zyrës;

Diplomë univerzitare ose përvojë ekuivalente;

Aftësi të mira për TiK (Microsoft Word, PowerPoint, Excel, web-aplikacione, etj.);

Njohuri mbi terminologjinë për financa dhe kontabilitet;

Aftësi për të ndërtuar mardhënie pune me të gjitha nivelet;

Aftësi për të shkruar dhe komunikuar;

Aftësi për të planifikuar....

3.2 Studim i shpalljeve online për punë

Kërkoni konkurse të ndryshme për punë. Shqyrtoni me kujdes. Çfarë kanë të përbashkë konkurset e punës? Cilat aftësi kërkohen? Si fitohen ato aftësi?

SEANCA 4

4.1 Zgjedhja e karrierës së Aleksandrit

Lexoni tekstin në vijim:

Aleksandri është në mbarim të shkollës së mesme. Teksa afrohet fundi i vitit shkollorë ai dhe shokët e klasës diskutojnë se çfarë i pret më pas. Një pjesë e tyre janë të sigurtë që do të vazhdojnë në fakultet. Të tjerët nuk janë të sigurtë, ndërsa disa duan të fillojnë të punojnë. Aleksandri ende nuk është i sigurtë nëse don të shkojë në fakultet. Nëse vendos të shkojë në fakultet, ai nuk është i sigurtë se dëshiron të studiojë.

Ai është i vetëdijshëm se numri i të pa punësuarve është i lartë dhe se nuk është e lehtë të gjendet punë as me diplomë fakulteti. Ai mendon se fakulteti i ndihmon që të gjejë një punë më të lehtë, atëher i'a vlen të regjistrohet. Por nuk e dinë sa është e vërtetë dhe nuk ka mënyrë se si ta provojë.

Një tjetër gjë që ai nuk e dinë, është se a do të ketë dëshirë të mësojë. Në shkollë të mesme kaloi mire. Megjithatë, nuk i donte të gjitha lëndët. Veçanërisht nuk e pëlqente Matematikën dhe Fizikën, gjegjësisht asgjë që kishte të bëjë me numra. Lënda që e donte ishte Historia dhe me të vërtetë ishte i mire në të. Veçanërisht e pëlqente historinë politike të shek.20 dhe luftërat botërore. Sidoqoftë, e don edhe pjesën tjetër të historisë njejtë. Ndonjëher lexon libra historik. Tezja e tij e pa pasionin e tij dhe i solli libra të tillë.

Ai mendoi se nëse shkon në fakultet, do ta regjistronte historinë. Megjithatë, u dëshpërua kur motra e tij i tha diçka. I tha se ka shumë pak vende pune si historian; edhe si professor në shkollë edhe si hulumtues në institute dhe muzeume historike. Kjo tingëlloi si e vërtetë dhe u mendua. Pse të studiosh diçka edhe pse e donë, përderisa nuk të ndihmon të gjesh punë?

Opsion tjetër e kishte ti ndjek shokët e tij dhe të regjistrohet bashkë me to. Ai i njihte disa shokë të klasës që kishin vendosur në këtë mënyrë. Ato i ndiqnin shokët e tyre. Disa prej shokëve të tij më të mire donin të studionin ekonominë. Përse të mësosh diçka që nuk e donë, vetëm të jesh bashkë me shokët?

Për disa shokë të klasës ishte më e lehtë. Ato kishin vizion të qartë se çfarë duan. Për disa prej tyre kishin vendosur prindërit dhe nuk kanë shumë hapsirë të mendohen. Njëri prej djemve e dinte që do të bëhet zdrukhtar si babai i tij. Njëra prej vajzave e dinte që do të bëhet kontabiliste, edhe pse i kishte thënë Aleksandrit se ajo në të vërtetë donte të bëhej aktore.

Duke u afruar fundi i vitit shkollorë, Aleksandri ende mendohet cila është zgjedhja më e mirë? A është më mirë të përqëndrohesh në një drejtim që ka më shumë vende pune, ose që pritet të hapen në të ardhmen?

Ose të përqëndrohesh në atë që e dëshiron në të vërtetë edhe pse e dine që nuk do të gjesh lehtë punë?

Ai ishte në dilemë nëse mund të jesh i mirë në diçka që nuk e dëshiron dhe anasjelltas?

I njihite disa shokë të klasës që i përkisnin në njërin prej këtyre kategorive.

A është zgjidhje ta veprosht njejtë si shokët e tu?

Dhe çka nëse prindërit tuaj vendosin diçka që ju nuk e doni, por ju mundëson të gjeni punë?

Termet kryesore:

Papunësi	Situatë ku nuk ka vende të mjaftueshme pune për ekonomi. Numri i njerëzve të pa punësuar.
Ekonomi	Shkencë që studion ekonominë.
Kontabilist	Person që drejton regjistrime financiare ose biznese të organizatave tjera.

4.2 Njoftimi me Skype

Temat që do të përfshihen:

- Hapja e nje llogarie Skype
- Përdorim i përgjegjshëm i Skype
- Punë me kontaktet
- Funksionaliteti i audio dhe videos
- Organizimi i thirrjeve grupore

4.3 Bisedë pune në Skype

Luani lojërat në vijim:

Roli 1:

Secili nga pjesëmarrësit paraqet një organizatë rinore nga rajoni. Organizatat bashkëpunojnë për herë të parë dhe nuk njihen mes vete. Ato së bashku organizojnë

një event për të rinjë dhe duhet të mbledhin të rinjë nga të gjitha vendet. Ato duhet të diskutojnë rreth akomodimit (rrugën, vendosjen) dhe agjendën (temat, prezentimet, etj.). Trajnuesi porositi pjesmarrësit në lojë të mos pajtohen me disa gjëra të propozuara nga të tjerët, por në mënyrë të sjellshme. Qëllimi është të mos bien dakord, por me respekt.

Roli 2:

Secili nga pjesmarrësit në lojë luan rrolin e shitësit. Të gjithë shitësit punojnë për kompaninë e njejtë në qytete të ndryshme të vendit. Ato bisedojnë për shitjen e një produkti të rri. Trajnuesi mund të rekomandon ndonjë produkt i cili do të jetë në interes të pjesmarrësve. Në fillim, secili nga pjesmarrësit bën prezentim të shkurtër të shitjeve në Qytetin e tyre për periudhën e kaluar. Pastaj fillon diskutimi për sfidat, strategjitë e shitjes etj.

SEANCA 5

5.1 Dilema për krijimin e CV

Lexoni tekstin në vijim:

Pas mbarimit të shkollës së mesme , Nusreti filloi ti ndjek konkurset dhe të aplikojë për punë . Të gjitha shpalljet për punë kërkonin të ju dërgohet CV. Punëdhënësit kërkojnë të ju dërgohet CV përmes emailit. Nusreti nuk kishte CV dhe kërkonte shembuj si të shkruante CV online. Gjithashtu vendosi të bisedojë me disa shokë të cilët tash më kishin CV.

Disa nga miqt e tijë mendonin se Cv-ja nuk duhet të jetë më e gjatë se një faqe. Thonin se ajo është poenta, të gjesh një mënyrë për të përfshirë të gjitha gjërat për veten në 1 faqe. Disa prej tyre thonin se CV-ja duhet të përmban edhe fotografi. Sa më e madhe fotografia, aq më mirë. Sidoqoftë disa nga shoket e tijë nuk pajtoheshin me këtë. Ata thonin se nuk është e patjetërsueshme CV-ja të jetë një faqe, por është vetëm një nga opsionet e mundëshme se si mund të bëhet. Ata mendonin se nuk është e mundëshme të tregohet përvoja e dikujt vetëm në një faqe. Gjithashtu thonin se mund të vendoset një fotografi e vogël, fotografia e madhe nuk duket edhe aq mirë në CV. Xheni, njëra nga mikeshat e tij tha se kishte ndëgjuar këshillat e të tjerëve dhe kishte vendosur një fotografi të madhe, por në intervistë, i kishin thënë se është joprofesionale. Dikush e këshilloi, dosjen që do ta dërgojë të mos jetë shumë e madhe, se punëdhënësit nuk e duan ashtu. Ajo e kishte dëgjuar këshillën.

Nusreti gjeti disa shembuj për CV prej në internet. Edhe pse ishin të ndryshme në format, ndiqeshin rregullat e njejta. Për shembull, përfshijnë informata rreth shkollimit dhe përvojave të punës. Të dyjat edhe shkollimi edhe përvojat duhet të radhiten nga më e reja deri tek më e vjetra. Në CV përfshihen edhe njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësite kompjuterike. Disa prej tyre përfshijnë edhe informacione shtesë, hobi, sjellje personale, etj.

Nusreti e përgaditi CV-në e tij, por kishte një problem. Ishte shumë i rri dhe nuk kishte përvojë pune. Ai kishte punuar disa punë të përkohshme gjatë veres. Kishte punuar si kamarier në një kafene, ka shpërndarë fletushka, kishte ndihmuar për ngarkim shkarkim, punoi si anketues, etj. Hamendeshte a ti përfshijë këto punë në CV. Një tjetër gjë ishte se nuk e dinte a do të dukeshin mië këto përvoja pune për t'u punësuar në zyrë. Ai mendoi se do të ishte më mire të mos i përfshinte këto punë në CV. Por, atëher shoku i tij Petar i tregoi se edhe ai nuk i kishte përfshirë punët sezonale që i kishte punuar, por kur kishte shkuar në intervistë në një kompani për shitje me pakicë personi që e kishte intervistuar i kishte thënë se secila përvojë e punës duhet

të theksohet në CV edhe nëse nuk ka të bëjë me punën që don të aplikosh sepse përvojat e ndryshme tregojnë se ke vullnet dhe je i gatshëm të punosh. Personi i kishte thënë se çdo përvojë është e rëndësishme.

Kjo ngjarje e shtyu Nusretin të mendohej. Kjo edhe i dukej shumë e arsyeshme dhe kishte kuptim sepse pa këto përvoja CV-ja do të ishte e zbrazur. U mendua, çfarë do të fitonte nëse e dërgonte CV-në e zbrazur?

Si të formulonte një CV ishte njëra prej temave që e diskutuan me shokët. Kishte shumë shembuj në internet, por shumë pak trajnime që mund të ndiqte. Kishte shumë udhëzime dhe nuk ishte i sigurtë cilën këshillë ta pranonte. Disa nga rekomandimet ishin shumë të dobishme. Shembull:

Nuk duhet të dërgohet e-mail për punë pa titull. Nuk është profesionale. Punëdhënësit mund të mos e dinë se me çfarë ka të bëjë e-maili dhe ta fshinë.

Nuk duhet të dërgosh email vetëm drejt me CV, pa tekst në porosi. Kjo gjithashtu është joprofesionale, madje edhe më keq se dërgimi i biografisë pa titull në porosi. Mjaftojnë vetëm disa fjali.

Nuk duhet ta dërgosh fajllin e CV-së pa emër ose me ndonjë emër të çuditshëm. Fajlli nuk duhet të jetë shumë i rëndë. Ka pasur raste kur kanë dërguar fajlle deri më 10MB.

Ai nuk kishte përvojë në dërgimin e aplikimeve për punë ose e-mail profesional, por e gjithë kjo kishte kuptim.

Duke kërkuar konkurset për punë, gjeti një shpallje për praktikant për shitje në një kompani të madhe. Vendosi ta dërgon CV-në e tij të parë.

Termet kyçe

Shpallje për punë	Lajmërim në gazeta ose në internet për vende të lira pune.
Intervistë për punë	Mbledhje në të cilën kandidati për punë përgjigjet në pyetje, zakonisht për aftësitë dhe përvojën e mëparshme të punës.
CV	Tekst i shkruar për arsimimin dhe përvojat e punës së dikujt.
Sjellje personale	Mënyra se si një njeri mendon dhe reagon, në situata të caktuara.
Shitje me pakicë	Shitje e mallrave në sasi të vogla.
Përvojë pune	Përvojë prej punëve të mëparshme
Trajnime	arsimim
Subjekti i porosisë (për e-mail)	Subjekt i porosisë është vendi ku vendoset titulli. Zakonisht shfaqet me termin „subjekt“. Titulli i emailit duhet të tregojë përmbajtjen.
Aplikim për punë	Kërkesë me shkrim për një punë të caktuar.
Shitje	Shitje e mallrave.
Praktikant	Person i cili punon për të fituar përvojë pune, shpesh herë pa rrogë, ose me pagë të vogël.

5.2 Kërkimi online i formateve për CV

Bëj hulumtime në internet dhe identifikoj forma të ndryshme të CV-së. Shikoni formate të ndryshme. Çfarë kanë të përbashkët? Me çka dallohen?

5.3 Krijimi i CV-së personale

Të krijojnë një CV personale.

SEANCA 6

6.1 Punësimi tek romët

Lexoni tekstin në vijim:

“Për më shumë se një mijë vite, Romët, duke përfshirë, manukotët, ashkalitë, sintit si dhe grupet e tjera pjesë e popullsisë Evropiane. Fjala „Romë“ u zgjodh për herë të parë në Kongresin e Inagurimit në Londër në vitin 1971 dhe përdoret si përskrim i përgjithshëm dhe pragmatik të komuniteteve të ndryshme. Në Evropën Qëndrore dhe Juglindore, gjatë tranzicionit të tregut ekonomik Romët ishin në disavantazh në mënyrë joproporcionale. Perspektiva historike ndihmon të shihet niveli i ulët i punësimi, varfëria e madhe dhe përjashtimi i Romëve i cili vazhdon edhe sot. Për shekuj me radhë Romët ishin të integruar në ekonominë lokale pranë shtëpive të tyre si farkëtarë dhe kujdeseshin për kalorësit. Industrializimi dhe postindustrializimi në shekujt 19 dhe 20 dhe rënia e kërkesës për shërbime tipike të romëve, së bashku me konsolidimin e shteteve kombëtare, i çoi romët që të braktisnin migrimin dhe të vendoseshin në një vend. Gjatë socializmit, romët shpesh kishin pozicionin e punëtorëve të pakualifikuar në industrinë e rëndë. Për një kohë të shkurtër standardi i romëve u përmesua dhe shumica prej tyre kishin akses në strehim, arsimim dhe sigurim shëndetësor. Tranzicioni i tregut ekonomik kishte pasoja të forta negative për romët. Mosfunksionimi dhe rënia e kompanive të mëdha shtetërore ka çuar në rënje kërkesën për forcën e pakualifikuar. Politikat për rikthimin e tokës i kanë detyruar romët të emigrojnë në zonat rurale të qytetit. Në Ballkanin Perëndimor, këto bariera ishin plotësuar me luftërat civile që kanë çuar në zhvendosjen e romëve në Bashkimin Europian”

... “Romët përbëjnë grupin më të madh të pakicave në Evropë, me një popullsi prej rreth 10 deri në 12 milionë. Edhe pse janë pothuajse në çdo vend të Evropës, ato janë më të përqendruara në Evropën Qendrore dhe Lindore - me më shumë se 3 milionë banorë në Rumani, Bullgari dhe Hungari, si dhe në Ballkanin Perëndimor ku shifra është rreth 600,000 në Serbi. Përveç numrit të madh të popullsisë rome, disa aspekte të tjera demografike e bëjnë situatën e tyre specifike... Ata nuk janë vetëm grupi më i madh i pakicave në Evropë, por numri i tyre tejkalon numrin e popullsisë së shumë vendeve evropiane..... Sipas një hulumtimi në 11 shtete anëtare të Bashkimit Evropian në vitin 2011, vetëm një nga tre romë ka vend pune, 9 nga 10 jetojnë në varfëri dhe përafërsisht 5 nga 10 ballafaqohen me diskriminim në bazë etnike. Përveç kësaj, në krahasim me plakjen e popullsisë evropiane, romët janë popullate më e re, mesatarja e romëve është 25 vjet në krahasim me atë të Evropianëve që është diku 40 vjet: të rinjtë romë përfaqësojnë 10-20 përqind të fuqisë së re të tregut të punës. Megjithatë, në vitin 2011 vetëm 15 përqind e të rinjëve romë kishin të kryer shkollimin e mesëm dhe pothuajse 60 përqind prej tyre mes moshës 16 dhe 24 ishin të pa punësuar, nuk ishin pjesë e sistemit arsimor ose ndonjë lloj trajnimi. Këto disavantazhe, të shoqëruara nga mungesa e përvojës së punës, e bëjnë integrimin e vështirë dhe urgjent të romëve në tregun e punës.”

Source: Promoting Decent Work Opportunities for Roma Youth in Central and Eastern Europe. An ILO

Resource Guide, International Labor Organization, 2016.

Termet kyçe:

Varfëria	Nuk ka burime të mjaftueshme për ti përmbushur nevojat themelore, ushqim, strehim, veshje, ngrohje.
Përfashtim social	Përfashtimi nga shoqëria, në kufijtë e shoqërisë, më shpesh për shkak të varfërisë dhe përkatësisë në një grup që është i diskriminuar bazuar në përkatësinë etnike, fenë, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar dhe të ngjashme.
Industrializim	Zhvillimi i prodhimit dhe prodhimit industrial.
Post-industrializimi	Faza e industrializimit, kur sektori i shërbimeve bëhet më i madh se prodhimi.
jo i kualifikuar	Një punëtor me aftësi të dobëta, shpesh të shoqëruara me një nivel të ulët të arsimimit.
Industria e rëndë	Zakonisht lidhet me industrinë metalike.
Tranzicion	Kalimi nga një fazë në tjetrën. Termi shpesh përdoret për të treguar një ndryshim nga socializmi në kapitalizëm.
Ekonomia e tregut	Një sistem ekonomik në të cilin prodhimi dhe çmimet krijohen nga kompani private.
Ndërmarrje shtetërore	Ndërmarrjet në pronësi të shtetit. Shpesh mendohet për llojin kryesor të ndërmarrjeve në socializëm.
Kthimi i tokës	Restaurimi i tokës në kontekstin e tokës që po kthehej pas përfundimit të socializmit.
Arsimi i lartë	Niveli i arsimit mes shkollës së mesme dhe fakultetit.
Puna e denjë	Puna që siguron shpërblim të mirë, siguri në vendin e punës dhe mbrojtje sociale.

6.2 Loja „Besilka“ me fjalët kyçe prej ushtrimit 6.1

Ndiqni udhëzimet e trajnuesit dhe interpretoni lojën.

6.3 Të shkruhet një ese e shkurtër mbi situatën e punësimit të romëve

Shkruani një ese të shkurtër mbi situatën e punësimit të romëve. Përdorni informacionet dhe fjalët e reja të mësuara nga ushtrimet e mëparshme.

SEANCA 7

7.1 Kategorizimi i aftësive për punësim

Ushtrimi: kategorizimi i aftësive

Ju lutem ndiqni udhëzimet e trajnuesit dhe punoni ushtrimin.

7.2 Matrica e aftësive për punësim

Rishikimi i matricave rreth aftësive për punësim.

abela 1. Aftësitë për punësim

Mendimi kritik	Të mësuarit gjatë gjithë jetës	Puna ekipore	Vetëbesim	Përgjegjësia dhe logaridhënia
<i>Të mund:</i>				
Të bëjë dallimin mes faktit dhe mendimit	Të jetë kureshtar dhe të kënaqet duke mësuar gjëra të reja	Ta kuptojë rolin e secilit në ekip	Të theksojë pikat e forta dhe të njohë kufizimet e veta	Të vendosni qëllime reale dhe punoni në drejtim të realizimit të tyre
Ti njohë, definojë dhe shpjegojë problemet	Të besosh se mësimi ka një rol në të gjitha sferat e jetës, jo vetëm në klasë	Të planifikon dhe të sjell vendime me të tjerët	Të provojë gjëra	Ti parashikojë pasojat e sjelljes së vet
Të qaset me informacione kritike kur ka nevojë të sjellet ndonjë vendim	Të kuptojë se çdoherë ka diçka më tej për të mësuar	Të vijë deri tek idetë dhe informacionet kryesore	Të mësojë prej gabimeve	Ta planifikojë si do ta shfrytëzojë kohën
Ti vlerësojë alternativat dhe ti parashikojë rezultatet	Të ketë dëshirë të mësojë mënyra të reja	Të përballë konfliktet dhe mendimet e ndryshme me respekt	Të mund të pranojë kritika dhe të jetë i hapur për përmesim	Ta kryejë punën në kohë dhe ti rrespektojë afatet
Të vendos për zgjidhje dhe të punon me to	Të mësojë vetë ose me të tjerë	Të tregojë ndjeshmëri	Të pranojë lëvdata për punët e mbaruara me sukses	Të jetë i pranishëm dhe i saktë në kohë
Ti shohë problemet si sfida	Ti aplikon njohuritë në situata të ndryshme	Praktikimi i dhënies dhe marrjes për të përfunduar punën ekipore	Të shpreh besim, mendim, ndjenja	Ta parashikojë sa kohë mer ndonjë detyrë
Aplikimi i njohurive në situata të reja	Të dijë kur të kërkon ndihmë	Rregullisht të merrë pjesë dhe të jepë komplimente për punët e kryera me sukses	Të krijojë marrdhënie pozitive	Ti shpjegojë veprimet pa i fajësuar të tjerët
Të sjell vendime të mira nën shtypje		Ta sigurojë udhëheqjen dhe ti motivojë të tjerët	Të zhvillojë lidhjet personale dhe profesionale	
		Ti mbështet vendimet e ekipës		

Burimi: Hache, L. et al., The Quick Reference Guide: Blueprint for Life/Work Designs, National Occupational Information Coordinating Committee, Washington, DC, US, 2000

Tabela 2. Struktura e aftësive për punësim

<p>Cilësitë personale që kontribuojnë në punësimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Besnikëria • Angazhimi • Ndershmëria dhe integriteti • Entuziazëm, relativitet 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeta e balancuar personale dhe profesionale • Aftësia për të përballuar presionin • Motivimi • Përshtatshmëria 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantim personal • Mendje e shëndoshë • Vetëbesim pozitiv • Ndjenja për humor
<p>Aftësi</p>	<p>Elementi - (aftësitë e identifikuara nga punëdhënësit si të rëndësishme, me një vërejtje se përparësia e aftësive mund të ndryshojë nga puna në punë)</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Elementi - (aftësitë e identifikuara nga punëdhënësit si të rëndësishme, me një vërejtje se përparësia e aftësive mund të ndryshojë nga puna në punë)</p>
<p>Komunikimi .. e cila kontribuon në produktivitetin dhe në marrëdhëniet harmonike mes punonjësve dhe konsumatorëve</p>	<p>Elementi - (aftësitë e identifikuara nga punëdhënësit si të rëndësishme, me një vërejtje se përparësia e aftësive mund të ndryshojë nga puna në punë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjim dhe mirëkuptim • Të folurit e qartë dhe të drejtë • Shkrimi i nevojave të publikut • Negocimi i përgjegjshëm • Vetëvlerësim • Empatia • Të flet dhe shkruajë në gjuhë të tjera përveç anglishtes • Përdorimi i numrave • Kuptimi i klientëve të jashtëm dhe të brendshëm • bindje efektive • Krijimi dhe përdorimi i rrjeteve • jo modest • Ndajja e informacionit 	<p>Planifikimi dhe organizimi ... i cili kontribuon në planifikimin strategjik afatgjatë ose afatshkurtër</p>	<p>Elementi - (aftësitë e identifikuara nga punëdhënësit si të rëndësishme, me një vërejtje se përparësia e aftësive mund të ndryshojë nga puna në punë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i kohës dhe prioritetet - përcaktimi i afateve kohore, koordinimi i detyrimeve dhe angazhimeve të tyre me të tjerët • Kredibiliteti • Marrja e iniciativave dhe sjellja e vendimeve • Adaptimi i shpërndarjes së burimeve për të adresuar mangësitë • Vendosija dhe shpërndarja e objektivave të qarta • Shpërndarja e kapitalit njerëzor dhe burimeve të tjera në varësi të detyrave • Planifikimi i burimeve, duke përfshirë menaxhimin e kohës • Merrni pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm dhe planifikimin e proceseve • Zhvillimi i vizionit dhe sjelljes proaktive • Parashikimi - llogaritja e rrezikut, vlerësimi i alternativave dhe zbatimi i kriterëve të vlerësimit • Mbledhja, analizimi dhe organizimi i informacionit • Kuptimi i sistemeve themelore të biznesit dhe marrëdhënieve

<p>Puna në grupe ... që kontribuon në marrëdhëniet produktive të punës dhe rezultatet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Puna me grupe të moshave të ndryshme pavarësisht nga gjinia, raca, feja dhe angazhimi politik • Punë individuale dhe si pjesë e një ekipi • Njohuri për të përcaktuar rolin si pjesë e një ekipi • Punë në ekip në situata të ndryshme, p.sh. planifikimin, zgjidhjen e situatave të konfliktit • Njohmi pikat e forta të anëtarëve të ekipit • Trajnim dhe mentorim, duke përfshirë dhënien e informatave kthyesë 	<p>Teknologjia ... i cili kontribuon në kryerjen efektive të detyrave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Duke pasur aftësi themelore për IT • Aplikimi i aftësive IT si një mjet menaxhues • Përdorimi i IT për organizimin e të dhënave • Dëshira për të mësuar aftësi të reja të IT • Having the OHS knowledge to apply technology • Kapacitet fizik për të aplikuar teknologjinë, p.sh. Aftësitë manuale
<p>Zgjidhja e problemeve ... të cilat kontribuojnë në rezultate produktive</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i zgjidhjeve krijuese dhe inovative • Zhvillimi i zgjidhjeve praktike • Demonstrimi pavarësisht dhe iniciativën në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve • Zgjedhje e problemeve në ekip • Zbatimi i strategjive për zgjidhjen e problemeve • Përdorimi i matematikës, duke përfshirë buxhetimin dhe menaxhimin financiar për zgjidhjen e problemeve • Zbatimi i strategjive për zgjidhjen e problemeve në fusha të ndryshme • Supozimet e testimit duke marrë parasysh kontekstin e të dhënave dhe rrethanave. • Heqja e kujdesit ndaj konsumatorëve në lidhje me problemet komplekse të projektit 	<p>Mësimi ... që kontribuon në përmirësimin dhe zgjerimin e operacioneve dhe rezultateve tek punonjësit dhe kompanija</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i të mësuarit • Kontributi në komunitetin për mësim në vendin e punës • Përdorimi i mediave të ndryshme mësimore - mentorim, mbështetje dhe rrjetëzim, IT, trajnime • Aplikimi i të mësuarit rreth “problemeve teknike” (p.sh. të mësuarit rreth produkteve) dhe problemeve ‘njerëzore’ (p.sh. aspektet ndërpersonale dhe kulturore të punës) • Entuziazmi i vazhdueshëm i të mësuarit • Keni dëshirë të mësoni gjëra të reja në çdo kontekst dhe jashtë punës • I hapur për idetë dhe teknikat e reja • Të jetë gati për të investuar kohë dhe përpjekje për të mësuar aftësi të reja • Ndërgjegjësimi i nevojës për të mësuar të përshtatet me ndryshimet

<p>Vetëmenaxhimi kontribuon në rritjen e kënaqësisë mes të punsuarve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Разрешување на грижата на корисниците за комплексни проекти • Имање на сопствена визија и цели • Евалуација и мониторинг на перформансите • Njohuri dhe vizion për idetë e veta • Ti shpreh idetë dhe vizionet e veta • Marrja e përgjegjësisë 	<p>Iniciativa dhe organizimi .. kontribuon në rezultate inovative</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshtatja në situatave të reja • Zhvillimi i vizionit strategjik, kreativ dhe afatgjatë • Të jeni kreativ • Identifikoni mundësitë që nuk janë të dukshme për të tjerët • Transferimi i ideve në veprim • Gjenerimi i mundësisë • Fillimi i zgjidhjeve inovative
-------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Burimi: Employability Skills for the Future 2002, Australian Chambers of Commerce and Industry and Business Council of Australia

SEANCA 8

8.1 Intervistë pune: Çfarë të bësh, dhe çfarë jo

Shikoni tabelën në vijim dhe diskutoni me pjesëmarrësit tjerë.

Çfarë të bësh	15 gjëra që duhet të shmangësh gjatë kohës së intervistës për punë
<p>Mbërrini 10-15 minuta më herët.</p> <p>Shfrytëzoni kohën gjatë pritjes për të rishikuar informacionet rreth punëdhënësit tuaj.</p> <p>Mbani një stilolaps dhe letër. Të kërkonit stilolaps tregon se keni shkuar i/e papërgaditur..</p> <p>Jini pozitiv, ajo mbahet mend.</p> <p>Dëgjoni me kujdes pyetjen para se të përgjigjeni.</p> <p>Nëse ka nevojë, pauzo para se të përgjigjesh në ndonjë pyetje të komplikuar.</p> <p>Vazho, edhe nëse ndjehesh sikur ke bërë diçka gabim.</p> <p>Mbaj një kopje shtesë të CV-ve dhe referencave të organizuara në një dosje.</p> <p>Mos diskutoni për pagën dhe përfitimet. Nëse ata ju kërkojnë, mos u përgjigjeni me një numër konkret (kam punuar rreth ... pasi isha student, qëllimi im ishte për të fituar përvojë dhe për të punuar diçka ...)</p> <p>Përgjigjet të jenë të shkurtëra dhe të qarta. Përderisa nuk duhet të japësh më shumë detaje, kufizojë përgjigjen tënde në 2-3 minuta në çdo pyetje.</p> <p>Parashtro pyetje. Pyetjet e mira duhet të përgaditen para kohe. Përderisa planifikon si të përgjigjesh në ndonjë pyetje, shkruaj edhe ndonjë pyetje konkrete që do të kishe dashur ta parashtrosh. Shembull:</p> <p>A mund ta përshkruani një ditë mesatare të punës?</p> <p>Si i vlerësoni aplikantët?</p> <p>Kush do të ishin eprorët dhe kolegët e mi?</p> <p>Si vlerësohet një punonjës dhe si mund të promovohet?</p> <p>Kush janë klientët tuaj? Kush është konkurrenti juaj?</p> <p>Cilat janë pritjet tuaja nga njerëzit e rinj? Cilat cilësi duhet të kenë ata?</p> <p>Sa shpejt do të marr një përgjigje nga ju?</p> <p>Kur do të merrni një vendim përfundimtar?</p> <p>Mbani një bisedë të butë, dijalog në vend se monolog, do të vlerësohet pozitivisht.</p>	<p>Të mbërrini vonë.</p> <p>Përfaqësim i keq personal.</p> <p>Mungesë interesi dhe entuziazmi: pasiv dhe indiferent.</p> <p>Të parashtroni pyetje rreth pages dhe përfitimeve.</p> <p>Të kritikoni punëdhënësin e më hershëm.</p> <p>Kontakt i keq me sy me punëdhënësin.</p> <p>Të mos parashtroni pyetje për punën.</p> <p>Përgjigje shumë të gjata për ndonjë pyetje.</p> <p>Tejkalimi i kompleksit “Unë di gjithçka”.</p> <p>Të mos jeni në gjendje të shprehni qartë veten.</p> <p>Mungesë e vetëbesimit dhe ekuilibrit, i stresuar.</p> <p>Ju gjeni justifikime, jeni të paqartë, nuk keni kujdes për disa gjëra.</p> <p>Mungesa e sjelljes së mirë.</p> <p>Aplikim pune i përgaditur keq.</p> <p>Pa interesim për kompaninë apo industrinë.</p>

Burimi: Surfing the Labor Market. Job Search Skills for Young People, International Labor Organization, 2012.

8.2 intervistë për punë: loja në rrole

Ndjekni këshillat e trajnuesit dhe kyçuni në lojë:

Roli 1:

Kandidati aplikon për vend pune si shitës në një dyqan të madh dhe të njohur të pajisjeve elektronike. Kandidati ka pak përvojë pasi që ai sapo ka mbaruar shkollën e mesme. Përvoja e punës përfshin punën gjatë verës dhe angazhimet e shkurtra. Kandidati ka nota të mira dhe njohuri të gjuhës angleze. Kandidati është i mirë me pajisje elektronike. Kandidati nuk ka përvojë paraprake të shitjes. Ai / ajo duhet të bindë të intervistuarin se ai ka aftësi të mira komunikimi dhe se ai do të jetë shitës i mirë.

Roli 2:

Kandidati aplikon për asistent në një organizatë joqeveritare lokale të Romëve. OJQ-ja punon me komunitetin që ofron ndihmë ligjore për romët, si dhe për shërbimet arsimore. Po ashtu punon për edukimin joformal të të rinjve. Një kandidat nuk kërkohet të ketë përvojë të mëparshme pune, por kërkon që ai të njihet mirë me komunitetin. Kandidati duhet të ketë aftësi të mira komunikimi, do të duhet të punojë në terren, të flasë me njerëz dhe të jetë në gjendje të kontaktoj me ta. Kandidati duhet të ketë njohuri themelore të diskriminimit, asistencë ligjore për romët, si dhe sfidat arsimore me të cilat ballafaqohen fëmijët dhe familjet rome. Nevojiten njohuri themelore dhe aftësim shtesë. Kandidatët duhet të kenë aftësi të mira për TIK, pasi të dhënat do të futen gjatë intervistave në terren.

Roli 3:

Kandidati aplikon në një agjencion për patundshmëri. Agjencioni mundëson me qira dhe shitje të një pjese të madhe të apartamenteve. Puna përfshin identifikimin e pronave të reja që reklamohen rregullisht, komunikimin me pronarët e pronave dhe klientët, komunikimin me avokatët, punën e kufizuar për kontratat, duke punuar me një bazë të dhënash të pronave. Puna nuk kërkon aftësi specifike teknike, por kandidati duhet të ketë aftësi të TIK, të flasë anglisht dhe të komunikojë. Aplikanti ka pak përvojë praktike gjatë shkollës së mesme. Ai / ajo duhet të bindë intervistuesit se ai është personi i duhur për këtë punë.

SEANCA 9

9.1 Sfidat për punësimin e të rinjëve Romë

Lexoni tekstin në vijim:

